



**AKCESK**

AUTORITETI KOMBËTAR PËR  
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK  
DHE SIGURINË KIBERNETIKE

**ASP** AKADEMIAE  
STUDIMEVE  
POLITIKE

# KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL SHQIPTAR KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË HAPËSIRËN KIBERNETIKE

**Autorë:**


Edlira Gjollëshi  
Esmeralda Hasani  
Saimir Kapllani

**Konsulent:**

Erjon Tase

Janar 2023

**Projekti “Sinjalizues të besuar për një ekosistemin  
kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm”**



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania

Botimi është pjesë e projektit “**Sinjalizues të besuar për një ekosistemin kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm**”, i mbështetur financiarisht nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

© Akademia e Studimeve Politike



**AKCESK**

AUTORITETI KOMBËTAR PËR  
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK  
DHE SIGURINË KIBERNETIKE



# KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL SHQIPTAR KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË HAPËSIRËN KIBERNETIKE

**Projekti “Sinjalizues të besuar për një ekosistemin  
kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm”**

**Autorë:**

Edlira Gjollëshi  
Esmeralda Hasani  
Saimir Kapllani

**Konsulent:**

Erjon Tase

Janar 2023



## TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE	5
II. ZHVILLIMI I KUADRIT LIGJOR	6
Strategjia për Sigurinë Kombëtare (2014)	6
Strategjia Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (2015)	7
Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit, 2021–2025, dhe Plani i Veprimit 2021–2023”	7
Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025	7
Konventat ndërkombëtare të ratifikuara	8
III. KUADRI INSTITUCIONAL	11
IV. PËRFUNDIMET DHE HAPAT E MËTEJSHËM	12
V. REFERENCAT	13

Ekstremizmi i dhunshëm dhe forcat që nxisin radikalizimin, të cilat sofistkohen çdo ditë duke shfrytëzuar jo vetëm boshllëqet ligjore, por edhe inovacionet teknologjike, vijojnë të mbeten ndër sfidat më të vështira të ditëve tona. Kërcënimet e reja të terroristëve që përdorin internetin për të realizuar qëllimet e tyre vijojnë të shtohen. Niveli i lartë i qasjes në internet dhe shtrirja e teknologjive të reja, si dhe domosdoshmëria e tyre në kohën që jetojmë ku njerëzit janë gjithnjë e më të ndërlidhur, rrit ekspozimin ndaj rrezikut të ekstremizmit. Në të njëjtën kohë, arsyet për të cilat ekstremistët dhe terroristët e dhunshëm radikalizohen janë komplekse.

Sipas studimeve të ndryshme, nuk ka asnjë mënyrë të sigurt për të parashikuar se kush do të radikalizohet ndaj dhunës, megjithëse studiuesit kanë përcaktuar një gamë të gjerë faktorësh të ndryshëm që kontribuojnë në fenomenin e radikalizimit. Këto mund të krijojnë një terren më të gjerë për teknologjitë e reja përmes të cilave transmetohen mesazhe manipuluese që krijojnë bindje tek përdoruesit, të cilët, për shkak të rrethanave të ndryshme, janë më të ndjeshëm dhe të cënueshëm prej radikalizimit, ekstremizmit të dhunshëm apo terrorizmit.

Për këto arsye, Shqipëria e ka bërë luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm një prioritet të rëndësishëm. Shqipëria është angazhuar për të përmbushur qëllimet e sigurisë kombëtare, për të pasur stabilitet dhe qëndrueshmëri si dhe për të parandaluar dhe luftuar kundër ekstremizmit të dhunshëm. Për këtë qëllim, është zhvilluar dhe konsoliduar korniza ligjore dhe institucionale në përputhje me *acquis* e BE dhe zhvillimet ndërkombëtare anti-terrorizëm, duke forcuar mekanizmat e brendshëm institucionalë dhe duke investuar në partneritete dhe iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit.

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (2015) si dhe Vendime plotësuese të Këshillit të Ministrave (2019 /2020) kanë orientuar fillimisht politikat shtetërore në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes një plani të dedikuar me masa për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit dhe aktorëve të përfshirë, rehabilitimin dhe riintegrimin e familjarëve të luftëtarëve të huaj të rikthyer nga zonat e konfliktit të Sirisë (verilindore) dhe Irakut, si dhe, ngritjen / rritjen e kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë (*front-line actors*) për sistemet e referimit (*case management system*), dhe trajtimin e rasteve të lidhura me ekstremizmin të dhunshëm e shumë aspekte të tjera.

Në vijim të zhvillimeve, vendi ynë miratoi Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Terrorizmit 2021–2025, dhe Plani i Veprimit 2021–2023<sup>1</sup> sipas rekomandimeve të Bashkimit Evropian. Këto zhvillime pozitive sa i përket luftës kundër terrorizmit u reflektuan edhe në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2021.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian, për Shqipërinë për vitin 2021<sup>2</sup>: “Shqipëria bëri përparim shumë të mirë në zbatimin e marrëveshjes dypalëshe me BE-në për operacionalizimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor. Nevojiten më shumë përpjekje për të trajtuar krimin kibernetik, trafikimin e qenieve njerëzore dhe rastet e pastrimit

---

<sup>1</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1137, datë 16.12.2020 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit, 2021–2025, dhe të planit të veprimit 2021–2023, [FZ-2021-5.pdf](#)

<sup>2</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2021

<https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/6e2fcf17-30ea-11ec-bd8e-01aa75ed71a1/language-en>

të parave. Teksa është bërë progres, Shqipëria duhet të shfrytëzojë në një mënyrë më proaktive produktet, shërbimet dhe kapacitetet e platformave të komunikimit të Qendrës Evropiane të Luftës Kundër Terrorizmit si dhe me Njësinë e Referimit të Internetit të Europol-it. Shqipëria duhet gjithashtu të vazhdojë të hetojë lidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit. Ajo mori pjesë aktivisht në zbatimin e iniciativës së luftës kundër terrorizmit të Ballkanit Perëndimor.”

Për shkak të ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe institucional të miratuara pas hyrjes në fuqi dhe implementimit të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021–2025, aktualisht ky dokument strategjik është në proces rishikimi duke integruar qasjen gjithëpërfshirëse të politikave për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit. Ky dokument strategjik është pasuruar me objektiva strategjike dhe objektiva të tjera specifike për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm, në shtyllën (qasjet) e parandalimit dhe reagimit.

Ndryshimet dhe shtesat në strategjinë ekzistuese synojnë reflektimin e përgjegjësive të strukturave, agjencive dhe institucioneve që kanë përgjegjësi në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe do të synohet gjithashtu forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Theksi i objektivave specifike në lidhje me parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm orientohet në fuqizimin e strukturave parandaluese dhe kundërshtuese të ekstremizmit të dhunshëm me mandatimin e roleve shtesë të tyre që do të ndihmojnë në kryerjen vlerësimeve periodike të nevojave, kryerjen e analizave dhe vlerësimeve funksionale ndaj fenomenit, shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me struktura inteligjente dhe ligjzbatuese. Zgjerimi i përgjegjësive pritet të mbështetëse dhe të garantojë rolin bashkërendues dhe koordinues në nivel kombëtar, si bërthamë qendrore, për shkak të mandatit të ri dhe duke shfrytëzuar përvojën praktike dhe aspektet pozitive të fituara në punën e kryer pranë komuniteteve në rrezik dhe familjeve të luftëtarëve të huaj të kthyer në Shqipëri, dhe parandalimit të fenomenit.

## II. ZHVILLIMI I KUADRIT LIGJOR

Politikat kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm online në Shqipëri janë të drejtuara nga dokumentet thelbësore **të mëposhtme:**

### Strategjia për Sigurinë Kombëtare (2014)<sup>3</sup>

Strategjia e Sigurisë Kombëtare reflekton zhvillimin e politikave shtetërore për sigurinë e njerëzve, shoqërisë dhe shtetit demokratik shqiptar kundër rreziqeve dhe kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme. Terrorizmi është përcaktuar në këtë dokument strategjik si një rrezik i vërtetë transkombëtar për sigurinë e Republikës së Shqipërisë (Pika 29.3, fq.12). “Pozicioni gjeo-strategjik i Shqipërisë është një element shtesë i vendin tonë për t’u përdorur si një rrugë komunikacioni dhe logjistike. Grupet militante dhe ekstremiste, të cilat përdorin dhunën si një mënyrë për të arritur objektivat e tyre politike, janë një rrezik serioz për sigurinë e jetëve njerëzore dhe për funksionimin e shtetit në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>3</sup> - Qeveria shqiptare po harton strategjinë e re 2020-2024, e cila ende nuk është vendosur për konsultim publik.

## Strategjia Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (2015)

Strategjia Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit Kombëtar adresojnë fenomenin e qasjes gjithëpërfshirëse ndaj parandalimit të faktorëve nxitës dhe shtytës si dhe fuqizojnë kryerjen e veprimeve konkrete si: akte të dhunshme dhe radikale që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm (*VERLT*), aksesin në komunikimet strategjike dhe shpërndarjen e propagandës ekstremiste duke përdorur format e komunikimit digjital në internet, si dhe riintegrimin e qytetarëve të rikthyer nga Siria dhe Iraku ose që jetojnë në vend që i janë bashkuar këtyre grupeve ekstremiste/terroriste.

## Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit, 2021–2025, dhe Plani i Veprimit 2021–2023”

Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021 – 2025 përfaqëson dokumentin themelor kombëtar strategjik në luftën kundër terrorizmit që kombinon agjendën e integritimit në Bashkimin Evropian në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të kapitullit 24, në fushën e luftës kundër terrorizmit, me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është orientimi i politikave dhe forcimi i qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj terrorizmit. Hartimi i kësaj strategjie e cila mbështetet në strategjinë e BE-së kundër terrorizmit, synon harmonizimin e veprimtarisë së strukturave, agjencive dhe institucioneve që kanë përgjegjësinë e luftës kundër terrorizmit.

Një nga qëllimet e kësaj strategjie shprehet nëpërmjet Politikës 1, dhe objektivat specifikë të cilët kanë në fokus parandalimin e radikalizimit nëpërmjet internetit përmes:

- Ndërprerjes së aktiviteteve të faqeve dhe platformave digjitale, si dhe individëve që tërheqin njerëz në terrorizëm
- Rritjen e prezencës së strukturave të antiterrorit në mjedisin virtual përmes kontrollit dhe monitorimit të hapësirave virtuale përfshirë *darknet*-in.

Një tjetër objektivi specifik i strategjisë është parandalimi i radikalizimit dhe rekrutimeve terroriste duke rritur bashkëpunimin bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar dhe me prodhuesit e aplikacioneve në internet.

## Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025

Një nga masat kryesore politike të kësaj strategjie (Politika 1, Objektivi 4) ka për qëllim të përmirësojë infrastrukturën e informacionit për të luftuar krimin kibernetik, radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Për të arritur këtë qëllim, synohet të ngrihen dy mekanizma për:

- Identifikimin e vazhdueshëm të elementëve të dëmshëm që qarkullojnë në internet dhe që shkelin sigurinë kibernetike në vend nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset.
- Rregullimin e ofrimit të shërbimit të internetit në zonat publike, nëpërmjet certifikimit nga autoriteti rregullues i sigurisë kibernetike.



Nënobjektivat e synuar janë:

- Monitorimi dhe parandalimi i fenomeneve, që nxisin ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin në shtresat vulnerabël në hapësirën kibernetike.
- Evidentimi në vazhdimësi i elementeve kontaminues, që qarkullojnë në internet, që cenojnë sigurinë kibernetike në vend.
- Ngritja e mekanizmave për rregullimin e internetit të sigurt në ambientet publike, të certifikuar nga autoriteti rregullues i fushës së sigurisë kibernetike.
- Ngritja e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse kundër krimit kibernetik.
- Rritja e bashkëpunimit rajonal në luftën kundër krimit kibernetik.

## Konventat ndërkombëtare të ratifikuara

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventat dhe Protokollet e Kombeve të Bashkuara mbi Terrorizmin dhe është gjithashtu një sponsor i Rezolutës 2178 të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara (2014), si dhe i Konventës së **Këshillit të Europës mbi Parandalimin e Terrorizmit** (CETS Nr. 196).

Shqipëria ka miratuar po ashtu **Rezolutën 1267 dhe 1373 të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara**, të cilat përcaktojnë procedurat për konfiskimin e pasurive për aktivitet terrorist. Shqipëria ishte një nga sponsorët e **Rezolutës 2178 e Kombeve të Bashkuara** (2014) për “Dënimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke nënvizuar nevojën për të parandaluar udhëtimin dhe mbështetjen për luftuesit e huaj terrorist”, e miratuar nga Këshilli i Sigurisë në Shtator 2014.

Në lidhje me sektorin e krimit kibernetik, Shqipëria ka harmonizuar legjislacionin e saj me **Konventën e Këshillit të Europës mbi Krimin Kibernetik** (ETS No.185). **Konventa e Budapestit mbi Krimin Kibernetik** u transpozua në ligjin kombëtar në Shqipëri në vitin 2008. Shqipëria ka për qëllim të përdorë Konventën e Budapestit si një sistem global për masat kundër krimeve të rrjeteve të informacionit. Shqipëria ratifikoi në vitin 2004 “Protokollin Shtesë të Konventës së Krimin Kibernetik për penalizimin e akteve me natyrë raciale dhe ksenofobike të kryera me anë të sistemeve kompjuterike” (ETS Nr. 189).

Një numër i rëndësishëm ligjesh dhe rregullash janë hartuar dhe përshtatur për zbatimin e këtyre qasjeve strategjike, si për shembull:

- **Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995**, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” (ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, ligjin 89/2017) ku në nenin 28 të të cilit “Forma të veçanta të bashkëpunimit”, në pikën 2, jepet përkufizimi i organizatës terroriste dhe në vijim parashikohen veprat penale të kryera me qëllime terroriste, parashikuar në Kreun VII të këtij kodi, si dhe nenet 265/a, 265/b dhe 265/c që parashikojnë sanksione për pjesëmarrësit në veprime luftarake në një shtet të huaj (ndryshime sipas ligjit nr. 98, datë 31.07.2014);
- **Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995**, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet kompetenca e hetimit të veprave penale që lidhen me terrorizmin, si dhe ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në bazë të të cilit është krijuar Prokuroria e Posaçme, që ka në kompetencë hetimin e veprave të kryera nga grupet terroriste;



- **Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008**, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas ligjit nr. 102/2012 në linjë me zhvillimet e fundit ligjore në “*acquis*” -in e BE-së;
- **Ligji nr. 9887, date 10.03.2010**, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, e ndryshuar, sipas Ligjit nr. 48/2012 dhe Ligjit nr. 120/2014;
- **Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010**, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”;
- **Ligji nr. 72, date 28.06.2012**, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapsinor në Republikën e Shqipërisë”;
- **Ligji nr. 72, date 28.06.2012**, “Për sigurinë kibernetike”, i përafuar me Direktivën (BE) 2016/1148 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 6 korrik 2016;
- **Ligj nr. 8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”**, i ndryshuar me me ligjin nr. 9541, datë 22.5.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;
- Ligj nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM Nr. 761, datë 12.12.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin nr 553, Datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”

Mekanizmat ligjorë të projektuara për të luftuar terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm janë aktualisht prezentë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Sipas Nenit 28/2 të Kodit: “Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste.” Kapitulli VII i Kodit Penal përmban 17 nene të tjera, të cilat përcaktojnë llojet e dhunës terroriste, krijimin dhe financimin e organizatave terroriste, si dhe rekrutimin dhe stërvitjen e individëve me qëllimin për të kryer akte terroriste.

Neni 230 i Kodit Penal është ndryshuar për të përfshirë krimet terroriste që kanë për qëllim të përhapin panik në popullatë ose të detyrojnë organet shtetërore, shqiptare ose të huaja të kryejnë apo të mos kryejnë një veprim të caktuar, ose të shkatërrojnë apo destabilizojnë rëndë strukturat thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni ose organizate ndërkombëtare, duke përfshirë:

- i) rrëmbimin e individëve;
- ii) dëmtimet serioze të pronës publike, infrastrukturës, sistemeve të transportit; rrëmbimin e avionëve, anijeve, mjeteve të tjera të transportit ose platformave fikse;
- iii) prodhimin, mbajtjen, blerjen, transportin ose tregtimin e eksplozivëve, armëve të zjarrit, biologjike, kimike ose bërthamore, si dhe hulumtime shkencore për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe me radhë.

Neni 230 / a ka për qëllim të pengojë financimin e terrorizmit duke dënuar një sjellje të tillë me 15 vjet burg, ndërsa Neni 230 vendos sanksione ndaj individëve që fshehin fonde të cilat përdoren për financimin e aktiviteteve terroriste.

Shumë prej ndryshimeve në Kodin Penal janë miratuar në vitin 2007, konkretisht në lidhje me Nenin 231 të Kodit, për të përfshirë në ligjin kombëtar detyrimet e ndërmarra nga Shqipëria në lidhje me ratifikimin e **Konventës Evropiane për Parandalimin e Terrorizmit duke dënuar “Rekrutimin e personave për kryerjen e veprave me qëllimeve terroriste ose financim të terrorizmit”**, madje edhe kur akte të tilla i drejtohen një shteti tjetër, institucioni ose organizatë ndërkombëtare. Në Tetor të vitit 2013, Kuvendi miratoi edhe ligjin nr. 157 “Për Masat kundër Financimit të Aktiviteteve Terroriste” (ndryshuar me ligjin nr. 43/2017, datë 6.4.2017; nr. 32, datë 17.6.2019). Ky ligj është në përputhje me kërkesat e rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Zbatimi i këtij ligji bëhet nga një sërë institucioneve dhe agjencish si Ministria e Drejtësisë, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP) dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ndërsa administrimi i llogarive dhe asetëve të ngrira/sekuestruara/konfiskuara bëhet nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Me këto ndryshime është synuar përbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Rekomandimi 6 i FATF.

Vitet e fundit janë bërë ndryshime në Nenin 265 / a, b, c të Kodit Penal. Këto Nene përcaktojnë masat e sigurisë që zbatohen për **personat që luftojnë në një vend të huaj** (Neni 256 / a); Organizimi për pjesëmarrje në luftime në një vend të huaj (Neni 256 / b); Thirrje për pjesëmarrje në akte të dhunshme në një vend të huaj (Neni 265 / c). Këto nene plotësojnë një kornizë tashmë të gjerë ligjore që rregullon veprimtaritë terroriste, ekstremizmin e dhunshëm dhe financimin e veprimtarive terroriste në Shqipëri.

Në përputhje me angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duhet të përafrohen direktivat dhe rregulloret e mëposhtme të BE-së në legjislacionin kombëtar:

- **Direktiva (BE) 2017/541/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 Mars 2017, mbi luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e Vendimit të Këshillit 2005/671/JHA
- **Rregullorja (BE) 2016/679** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 27 Prill 2016, mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave).
- **Direktiva (BE) 2016/680** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 27 datës Prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA.
- **Rekomandimi i Komisionit (BE) 2018/334**, i datës 1 mars 2018, “Mbi masat për trajtimin efektiv të përmbajtjes së paligjshme në internet”.
- **Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) 2021/784** “Mbi adresimin e shpërndarjes së përmbajtjes terroriste *online*.”

### III. KUADRI INSTITUCIONAL

---

Përpjekje konkrete janë ndërmarrë për krijimin dhe funksionimin e disa strukturave që sigurojnë dhe garantojnë zbatimin e kornizës ligjore për mundësimin e një mjedisi më të sigurt në internet nga përmbajtja e paligjshme:

**Qendra për Koordinimin Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm** u krijua nga VKM nr. 737, e datës 13.12.2017, e ndryshuar në 20.04.2022<sup>4</sup> si dhe 29.06.22. Qendra CVE shërben si një katalizator për ndërtimin e kapaciteteve, identifikimin e nevojave dhe mekanizmave funksionues në lidhje me Strategjinë Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit. Konceptet dhe masat e hartuara në këto dy dokumente kanë vënë disa detyrime për të gjitha Ministrinë Përgjegjëse, institucionet dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm, siç janë shoqëria civile, komunitetet fetare, media dhe partnerët ndërkombëtarë. Përmes kësaj Strategjie, Qendra ka mundësinë të zhvillojë parime udhëzuese, politika dhe veprime për të përballuar radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm në territorin e Shqipërisë, por edhe për t'u koordinuar me rajonin ose më gjerë për të ndërmarrë nisma të përbashkëta parandalimi. QKEDH<sup>5</sup> harton programe të punësimit dhe informimit në kuadër të parandalimit dhe kundërshtimit përmes policisë në komunitet të ekstremizmit dhe radikalizimit që çon në ekstremizëm (P/CVE), si dhe uljen e ndikimit të propagandës ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive. Në vijim të miratimit të VKM-së 826, datë 26.10.2020 lidhur me procesin e riatdhesimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, QKEDH ka si detyrim koordinimin ndër-institucional, mbështetjen dhe monitorimin e procesit të riatdhesimit dhe zhvillimin e programeve rehabilituese dhe riintegruese.

**Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)** është një organ publik, i cili funksionon nën autoritetin e Kryeministrit, në zbatim të Ligjit Nr. 9880/2018 "Për Nënshkrimin Elektronik", Ligjit Nr. 107/2015, i datës 1.1.2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", Ligjit Nr. 2/2017 "Për sigurinë kibernetike". Autoriteti synon të sigurojë besueshmërinë dhe sigurinë në transaksionet elektronike midis qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin e shërbimeve publike, private dhe tregtisë elektronike; vendos standarde minimale teknike për sigurinë e të dhënave dhe për rrjetet/sistemet e shoqërisë së informacionit në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë, me qëllim krijimin e një mjedisi elektronik të sigurt.

**Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)** - si institucioni rregullator dhe koordinues i rrjeteve të shpërndarjes së shërbimeve të komunikimeve elektronike, kryesisht shërbimeve të internetit dhe të telefonisë i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë së rrjeteve fizike dhe infrastrukturave të internetit dhe telefonisë nga sulme të gjithfarëlojshme, përfshirë këtu edhe ato me synime terroriste, me qëllim parandalimin e cënimit, paralizimit apo keqpërdorimit të rrjeteve dhe shërbimeve fizike përmes të cilëve personat juridikë, publikë apo privatë, si edhe qytetarët, kanë akses të pandërprerë dhe cilësor në përdorimin e internetit dhe të telefonisë.

<sup>4</sup> <https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-20-prill-2022/>

<sup>5</sup> QKEDH e njohur ndryshe edhe si Qendra CVE.

**Policia e Shtetit** është institucioni përgjegjës për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, ndër të cilat përfshihen edhe veprat penale në fushën e TIK-ut, me të cilat merret Sektori i Krimit Kompjuterik dhe Drejtorja e Antiterrorit për përmbajtjen terroriste online.

**Prokuroria e Përgjithshme** ushtron ndjekje penale kundër veprave penale në fushën e kibernetikës përmes Sektorit të Krimeve Kompjuterike. Kjo strukturë kontrollon veprimtarinë e njësisve speciale që merren me krimet në internet, të cilat janë ngritur pranë Prokurorive të Qarkut.

**Shërbimi i Informativ i Shtetit (SHISH)** përmes Sektorit të Krimit Kibernetik është përgjegjës për kërkimin, zbulimin dhe analizimin e krimeve në internet që kërcënojnë sigurinë kombëtare.

## IV. PËRFUNDIMET DHE HAPAT E MËTEJSHËM

---

Analizat e kuadrit ligjor aktual demonstrojnë mungesën e akteve ligjore për rregullimin e marrëdhënieve dhe përcaktimin e qartë të detyrave dhe të drejtave mes aktorëve publikë dhe atyre privatë me qëllim bllokimin ose fshirjen në kohë të materialit me përmbajtje të dhunshme ekstremiste. Legjislacioni shqiptar duhet të harmonizohet sa më shpejt që të jetë e mundur me *Acquis Communautaire* të BE-së, duke krijuar një mekanizëm të plotë dhe të qartë të kodifikuar për të adresuar siç duhet këtë çështje.

Në strategjinë aktualisht në rishikim janë parashikuar masa si:

- krijimi i një sistemi të aksesit të kontrolluar për grupmoshat e reja në site dhe faqe online të cilat mund të kenë përmbajtje propagandiste;
- krijimi i hapësirave për denoncimin e faqeve/profileve të dyshimta në faqet zyrtare të Policisë së Shtetit, AKCESK, QKEDH etj.;
- zhvillimi i spoteve ndërgjegjësuese për t'u shpërndarë tek përdoruesit e internetit, nëpërmjet profileve zyrtare të agjencive shtetërore apo faqeve zyrtare të internetit;
- monitorimi i faqeve të internetit nga agjencitë ligj-zbatuese për mesazhe/profile radikale, ekstremiste e terroriste duke synuar bllokimin e të gjitha faqeve (links; në raste të caktuara edhe *domain-e*) apo i aplikacioneve që në përmbajtje kanë propagandë terroriste, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike (ofruesit e shërbimit internet – ISP);
- monitorimin e rrjeteve sociale dhe mediave elektronike në lidhje me shtetasit shqiptarë (LHT) që mund të kthehen nga zonat e konfliktit Siri/Irak dhe individët e dyshuar për terrorizëm;

Është e nevojshme që të gjitha këto mekanizma dhe masa të gjejnë mbështetjen e duhur nga vendimmarrësit dhe aktorët e tjerë dhe të vihen në jetë pa humbur kohë duke siguruar bashkëpunimin e duhur mes aktorëve institucionalë si dhe bashkërendimin e pritshëm me aktorët privatë, ofrues të shërbimeve të platformave online si dhe vetë përdoruesve të internetit.

## V. REFERENCAT

---

**Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik (ETS nr.185)** - <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/185>

**Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit (CETS nr.196)** - <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/196>

**Rezolutat 1373 (2001) e Këshillit të Sigurimit të OKB mbi kërcënimet për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare të shkaktuara nga akte terroriste** - [https://undocs.org/S/RES/1373\(2001\)](https://undocs.org/S/RES/1373(2001))

**Rezoluta 2178 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2014)** - <https://www.un.org/securitycouncil/s/res/2178-%282014%29>

**Strategjia Shqiptare e Sigurisë Kombëtare (2014)** - <http://www.mod.gov.al/eng/index.php/security-policies/strategic-documents/100-national-security-strategy>

**Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (2015)** - <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/strategjia-2018-me-ndryshime.pdf>

**Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025** [https://cesk.gov.al/legjislacioni/2020/strategjia\\_kombetare\\_sigurise\\_kibernetike.pdf](https://cesk.gov.al/legjislacioni/2020/strategjia_kombetare_sigurise_kibernetike.pdf)

**Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare e Luftës kundër Terrorizmit 2021–2025** <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/vendim-2020-12-16-1137.pdf>

### **Këshilli i Ministrave**

<https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-20-prill-2022/>

### **Draft-Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Terrorizmit dhe Planit të Veprimit 2021-2025**

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/312>

### **Draft-Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021-2030 (SKZHIE III)**

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/538>

**Direktiva (BE) 2017/541** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 Mars 2017, mbi luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/475 / JHA - <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017L0541>

**Rregullorja (BE) 2016/679** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 27 Prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave - <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2016/679/oj>

**Direktiva (BE) 2016/680** e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 27 Prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente - <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32016L0680>

**Direktiva e Terrorizmit (BE) 2017/541** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 Mars 2017, mbi luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/475/JHA - <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017L0541>

**Rekomandimi i Komisionit (BE) 2018/334**, i datës 1 mars 2018, “mbi masat për trajtimin efektiv të përmbajtjes së paligjshme në internet”. - <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32018H0334>







## **Akademia e Studimeve Politike**

Rruga "Emin Duraku", Pallati Credins  
Hyrja 1, kati 7, Ap. 21  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 5629047,  
E-mail: [info@asp.al](mailto:info@asp.al)  
Web: [www.asp.al](http://www.asp.al)